



## BASHKIA SKRAPAR

### PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Punë

#### **PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

**OBJEKTI I PROCEDURËS: Rehabilitimi i digës së rezervuarit Staraveckë, Bashkia Skrapar**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 45247270-3**

**VLERA E FONDIT LIMIT: 44 405 429** (dyzetë e katërmilion e katërqind e pesëmijë e katërqind e njëzetë e nëntë) **lekë pa TVSH.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Skrapar ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

#### **I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*
- b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

**Argumentimi:** Për pikën a.- në Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Neni 82 si dhe në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 26; për pikën b.-në zbatim të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin Publik”, neni 83 “Sigurimi i ofertës”, pika 1 dhe 2, si dhe VKM-së nr. 285 dt.12.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 30 “Sigurimi i ofertës”, pika 1, 2 dhe 3.

**2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

#### **2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):**

Kjo kërkesë konsiderohet e plotësuar, nëse operatori ekonomik ofertues, është kualifikuar për kriteret e përgjithsme të kualifikimit, të përshkruara në pikën 1, sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, të dorëzuar prej tij, në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

#### **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar**

**2.2.1** Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar për 3 (tre) vitet e fundit financiare (2023, 2024, 2025), ku vlera e xhiros, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar, **duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit të objektit të prokurimit.** (e shprehur në lekë 44,405,429)

*Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse Operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga Autoriteti Kontraktor.*

**Argumentimi:**

*(Në zbatim të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, pika 3, si dhe VKM-së nr. 285 dt.12.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 43 “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare”, pika 1 dhe pika 2 gërma b), si dhe neni 61, pika 2, të Ligjit Nr. 29/2023 Për Tatimin mbi të Ardhurat, i ndryshuar, ku parashikohet se: 2. Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata.*

**2.2.2** Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për tre vitet financiare (2023, 2024, 2025), që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit, të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar. Kërkesa konsiderohet e përmbushur **nëse në dy bilancet e njëpasnjëshme të kërkuara, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.**

**Argumentimi:**

*(Në zbatim të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin Publik”, neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, pika 3, si dhe VKM-së nr. 285 dt.12.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 43 “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare”, pika 4.)*

**Shënim:** Akt Ekspertiza e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, duhet të paraqitet nga OE vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit **41, gërma “c” të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009** “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, ku parashikohet se:

*“Detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese:*

*c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur në mbyllje të periudhës kontabël tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm:*

*i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 40 milionë lekësh;*

*ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 30 milionë lekësh;*

*iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël.*

**Argumentimi:**

*(Në zbatim të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, pika 3, si dhe VKM-së nr. 285 dt.12.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 43 “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare”, pika 4.) Njësia e prokurimit e vlerëson të nevojshëm kriterin për xhiron mesatare, dorëzimin e*

---

dokumentit përkatës vërtetim dhe pasqyrat financiare vjetore, pasi vërtetojnë kapacitetet ekonomike, financiare të operatorit ekonomik me qëllim përmbushjen dhe realizimin e kontratës. Kapaciteti pozitiv financiar i operatorit i dokumentuar me bilance apo pasqyra financiare për tre vite buxhetore i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatoreve ekonomikë në një periudhë të afërt me prokurimin e tanishëm, dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës. Pasqyrat financiare me bilanc pozitiv dhe gjendja financiare bankare paraqesin me vërtetësi dhe besueshmëri pozicionin financiar të operatorit ekonomik.

**2.2.3** Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetimet që dëshmojnë se kanë paguar detyrimet përkatëse, të taksave dhe tarifave vendore, në përputhje me percaktimet e ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, në të gjitha vendet ku kanë ushtruar aktivitet sipas të dhënave të QKB-së, për detyrimet e vitit 2025 dhe ato të maturuara për vitin 2026.

**Shënim:** Operatorët ekonomikë për përmbushjen e kësaj kërkesë duhet të **vetëdeklarojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST, se kanë paguar detyrimet përkatëse, të taksave dhe tarifave vendore, në përputhje me percaktimet e ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, në të gjitha vendet ku kanë ushtruar aktivitet sipas të dhënave të QKB-së, për detyrimet për vitin 2025 dhe detyrimet e maturuara për vitin 2026 (në seksion të veçantë nga taksat dhe detyrimet tatimore në formularin e deklarimit nr.8).**

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

#### **Argumentimi:**

**(Në zbatim të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin Publik”, neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, dhe ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar. Njësia e prokurimit e vlerëson të nevojshëm vendosjen e këtij kriteri, pasi tregon që operatorët ekonomikë i kanë paguar të gjitha detyrimet e taksave për kryerjen e aktivitetit në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi;)**

### **2.3 Kapaciteti teknik**

Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, operatorët ekonomikë, duhet të garantojnë që zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme, për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie, duke përmbushur kërkesat si më poshtë:

#### **2.3.1** Për të provuar përvojën e mëparshme

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se **50%** e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet (e shprehur në lekë 22,202,714) dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;

ose

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet. (e shprehur në lekë **88,810,858** ).

### **Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.**

Autoriteti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, **kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik**, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen **vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë**, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve, si dhe:

- Situacionin përfundimtar të punimeve (për të vërtetuar natyrën e punës së kryer)

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti kontraktor kërkon si dëshmi, **vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës**, ku të shënohen **vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë**, e shoqëruar me **fatura tatimore të deklaruara në organet tatimore**, si dhe:

- Situacionin përfundimtar të punimeve (për të vërtetuar natyrën e punës së kryer)

**2.3.1.1** Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatorësh, operatori ekonomik ofertues, krahas dokumentacionit të sipërcituar, për secilin rast respektivisht, duhet të paraqesë edhe Kontraten e bashkimit të operatoreve shoqëruar me tabelën e ndarjes së punimeve, ku të cilësohen punimet që ka marrë përsiper të kryejë secili anëtar i BOE.

**2.3.1.2** Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën bazë ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor, si dhe miratimin zyrtar si nënkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor.

*Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, pika 2.3.1 gërma a), plotësohet nga anëtarë, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cili prej tyre do të përmbushë këtë kusht.*

#### **Argumentimi:**

*((Në zbatim të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin Publik”, neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, pika 4, si dhe VKM-së nr. 285 dt.12.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 39 “Kërkesa të vecanta për kontratat për punë publike”, pika 5, dhe neni 88 “Bashkimi i operatorëve ekonomikë” pika 3, si dhe për të përcaktuar saktë natyrën e punimeve të ngjashme të realizuara me sukses))*

---

## 2.4 Licenca profesionale

Operatori ekonomik ofertues, duhet të zotërojë licencë profesionale në fushën e zbatimit të punimeve në ndërtim, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore, e cila të përmbajë kategoritë si më poshtë:

### PUNIME TË PËRGJITHSHME NDËRTIMI

- N.P. – 1 A:** Punime gjurmimi në tokë.
- N.P. - 4 A:** Rrugë autostrada, ura, mbikalime, hekurudha, linja tramvai, metro, hekurudhë me kavo dhe pista aeroportuale.
- N.P. – 6 B:** Diga dhe tunele hidroteknike
- N.P. - 7 A:** Ujësjellësi, gazsjellës, vajsjellës, vepra kullimi e vaditje
- N.P. - 8 A:** Ndërtime detare dhe punime thellimi në ujë

### PUNIME SPECIALE NDËRTIMI

- N.S. – 18 B:** Punime topogjeodezike

#### Argumentimi:

*(Në zbatim të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, pika 4, si dhe VKM-së nr. 285 dt.12.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 39 “Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike”, pika 6 gërma a), VKM-së nr. 42, datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar, si dhe në përputhje me zërat e punimeve të parashikuara në preventivin e punimeve si dhe grafikun e detajuar të punimeve me kohët e punës, numrin e punonjësve, numrin e specialistëve, numrin e drejtuesve teknikë, licencat e nevojshme dhe makineritë dhe paisjet, të hartuar nga specialisti i fushës në njësinë e prokurimit. Argumentimi i licencave përshkruhet në tabelën e mëposhtme):*

| Analiza       | Argumentimit i analizës sipas VKM.42                                                                                                                                                                                                   | Niveli i shoqërisë                         | Zërat e punës në preventiv                                                                                                                                                                                                                                                                                                 |
|---------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <b>N.P.-1</b> | Konsiderohen gjurmimet, sistemimet dhe ndryshimet në volum të tokës, të realizuara me çfarëdo lloj mjeti, pavarësisht nga natyra e terrenit që do të gjurmohet ose sistemohet vegjetale, argjilore, ranore, zhavorishte ose shkëmbore. | <b>A:<br/>Vlera e punimeve 0-20 milion</b> | Sipas emërimit në preventiv "Gjurmim e transport dhe me skreper deri në 100 ml për skarifikimin e trupit të digës me t=20 cm, në të dy skarpatat e saj (e sipërme dhe e poshtme)"; "Gjurmim për riformatim të trasës rruges, 80% me makineri"; "Mbushje + ngjeshje me dhe";.... etj. Vlera e punimeve më pak se 20 milion. |
| <b>N.P.-4</b> | Përfshin në mënyrë të thjeshtuar rrugët, pavarësisht nga shkalla e tyre e rëndësisë, autostradat, superstradat përfshirë ndërhyrjet në pika të veçanta, tunelet, devijimet në nivele dhe në                                            | <b>A:<br/>Vlera e punimeve 0-20 milion</b> | Sipas pikës në preventiv: "D. Ndërtim 2 rrugë aksesi për në digë (një rrugë lidhëse me rrugën e Teqesë dhe një rrugë nga                                                                                                                                                                                                   |

|                |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                      |                                             |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                   |
|----------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|---------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
|                | lartësi, parkimet, punime të mureve mbajtëse, hekurudha, metro, hekurudhë me kavo, tramvaj, pista aeroportuale, sheshet e helikopterëve, sheshet të realizuara me materiale të veçanta, natyrale dhe artificiale, <b>urat</b> , si dhe komplekse karakteristikash teknike, në hekur, betonarme të thjeshtë dhe të paranderur, parafabrikat ose të prodhuar në objekt.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                |                                             | fshati (nga kreu i lagjes në vijim deri tek rezervuari)".<br>Vlera e punimeve më pak se 20 milion                                                                                                                                                                                                                                                                                 |
| <b>N.P.-6</b>  | Konsiderohen ndërtime, <b>mirëmbajtje ose rristurime me ndërhyrje të sakta, që janë të nevojshme për të ruajtur ujin e grumbulluar të zbatuar për çfarëdo lloj motivi</b> , të lokalizuara në drejtim të rrjedhjes. Përfshin <b>diga të ndërtuara me çfarëdo lloj materiali</b> .                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                    | <b>A:<br/>Vlera e punimeve 21-50 milion</b> | Sipas emërimit të preventivit "Punime për rehabilitimin e digës së rezervuarit të Staraveckës Bashkia Skrapar". Të gjitha punimet e preventivit, përveç "Ndërtim 2 rrugë aksesi për në digë (një rrugë lidhëse me rrugën e Teqesë dhe një rrugë nga fshati (nga kreu i lagjes në vijim deri tek rezervuari)". Vlera e punimeve më shumë se 21 milion dhe më pak se 50 milion.     |
| <b>N.P.-7</b>  | <b>Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose rristurime me ndërhyrje në rrjet që janë të nevojshme për realizimin "e shërbimit hidrik kompleks"</b> ose për transportimin në vendet e përdorimit të gazrave, vajrave dhe veprave lidhëse, plotësuese ose ndihmëse edhe në pika të veçanta si edhe në të gjitha impiantet mekanike të nevojshme për të pasur një shërbim të mirë të nevojshëm gjatë përdorimit, funksionimit, informimit, sigurisë dhe asistencës për një funksionim normal. Përfshin në mënyrë të thjeshtuar <b>veprat e kaptazhit të ujit</b> , impiantet e trajtimit të ujit të pijshëm, ujësjellësit, kullat e ujit, stacionet e pompimit, depozitat në tokë ose të ngritura, rrjetin shpërndarës deri tek përdoruesi, <b>furnizimi dhe vendosja në vepër e tubacioneve</b> , shkarkimet e ujërave të zeza, si dhe trajtimin e ujërave të përdorura. | <b>A:<br/>Vlera e punimeve 0-20 milion</b>  | Sipas pikës në preventiv: B. Punime për shkarkuesit katastrofik të rezervuarit dhe pikës C. Punime për rikonstruksionin e ujëlëshuesit të rezervuarit.<br>Vlera e punimeve më pak se 20 milion                                                                                                                                                                                    |
| <b>N.P.-8</b>  | Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose <b>rristurime me ndërhyrje të sakta të realizuara në ujëra të ëmbla</b> ose të kripura, që i përkasin terminaleve "ujore" ose vepra mbrojtëse territori nga ujërat detare ose të ëmbla, e kompletuar me veprat lidhëse, plotësuese ose ndihmëse edhe të tipit të veçantë për të pasur një shërbim të mirë të përdoruesit, funksionimit, informimit, sigurisë dhe asistencës. Përfshin në mënyrë të thjeshtuar portet, molet, bankinat, panelet, platformat, pontilet, mbrojtje detare, shkëmbinj nënujore, ujësjellësit nënujorë, <b>vepra shkarkimi, si edhe punime të drenimit e thellimi në det të hapur, në pellg ujëmbledhës, të mbrojtjes kundër erozionit nga ujërat e ëmbla ose të kripura</b> .                                                                                                                      | <b>A:<br/>Vlera e punimeve 0-20 milion</b>  | Sipas pikës në preventiv C. Punime për rikonstruksionin e ujëlëshuesit të rezervuarit dhe 1. Riparimi i pusëtës së hyrjes së ujëlëshuesit, B. Punime për shkarkuesit katastrofik të rezervuarit që do të shoqërohen me punime speciale për përforcim bazamenti në prezenc lym. në tabanin e ujëmbledhësit, punime thellimi e drenimi etj.<br>Vlera e punimeve më pak se 20 milion |
| <b>N.S.-18</b> | <i>Konsiderohet zbatimi i rlevimeve topografike speciale që kërkojnë mjete dhe organizim të veçantë, <b>punime topogjeodezike në objekte inxhinierike</b>, punime speciale gjeodezike; rrjeta mbështetëse dhe qëndrueshmëri terrenesh.</i>                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                           | <b>B:<br/>Vlera e punimeve 21-50 milion</b> | Për punimet topogjeodezike në objekte inxhinierike, drejtimet dhe kuotat, kryesisht për punimet për ndërtimin e dy rrugëve, kanalit të shkarkimit katastrofik dhe ujëlëshuesit, punimet për kuroren e                                                                                                                                                                             |

|  |  |  |                                                                                                                                                                       |
|--|--|--|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
|  |  |  | diges, llogaritjen dhe kontrollin e punimeve të gërmimit dhe mbushjeve, shtresave dhe drenazheve etj. Vlera e punimeve më shumë se 21 milion dhe më pak se 50 milion. |
|--|--|--|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|

## 2.5 Stafi dhe punonjësit

**2.5.1** Operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duhet të kenë të punësuar drejtuesit teknik, që kanë në licencën e shoqërisë, të cilët të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për muajin e fundit (Maj 2026) nga data e hapjes së ofertave, si më poshtë:

- |                         |         |
|-------------------------|---------|
| – Inxhinier ndërtimi    | 1 (një) |
| – Inxhinier hidroteknik | 1 (një) |
| – Inxhinier gjeodet     | 1 (një) |

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, **sipas shtojcës nr. 8. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese.** Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin, si më poshtë:

*Për secilin pjesëtar të stafit teknik të mësipërm duhet të paraqitet:*

- *Të figurojë si komponent i listës së drejtuesve teknik në licencën e subjektit*
- *Licencën personale profesionale.(nëse ka)/ kopjen e diplomës*
- *Drejtuesit teknik të jenë të siguruar sipas legjislacionit në fuqi, në listëpagesat e muajit të fundit që është kërkuar më poshtë.*

**2.5.2** Operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duhet të kenë të punësuar punonjës të kualifikuar në profesionet si më poshtë:

### A. Specilistë ndërtimi

- |                                |              |
|--------------------------------|--------------|
| – Teknik Ndërtimi              | 1 (një)      |
| – Topograf                     | 1 (një)      |
| – Gurëpunues                   | 5 (pesë)     |
| – Hekurthyes                   | 4 (katër)    |
| – Saldatorë                    | 2 (dy)       |
| – Karpentierë                  | 6 (gjashtë)  |
| – Muratorë                     | 4 (katër)    |
| – Punonjës të tjerë (punëtorë) | 20 (njëzetë) |

## **B. Drejtues të makinerive të rënda të ndërtimit dhe drejtues kamioni**

|                                               |           |
|-----------------------------------------------|-----------|
| – Eskavatorist                                | 3 (tre)   |
| – Buldozerist                                 | 4 (katër) |
| – Automakinistë                               | 2 (dy)    |
| – Drejtues kamioni me Leje drejtimi të tipi C | 2 (dy)    |

Për specialistët e kërkuar më sipër ( pika 2.5.2 gërma A ) të paraqiten:

- diplomë/ dëshmi/ certifikatë/ ose çdo dokument tjetër që vërteton kualifikimin e tyre
- kontrata e punës, e vlefshme për të paktën, periudhën e parashikuar të realizimit të punimeve
- të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë, të paktën, për **muajin e fundit (Maj 2026)** nga data e hapjes së ofertave.

Për drejtues të makinerive të rënda të ndërtimit dhe drejtues kamioni ( pika 2.5.2 gërma B ), të kërkuar më sipër të paraqiten:

- kontrata e punës, e vlefshme për të paktën, periudhën e parashikuar të realizimit të punimeve;
- Dëshmi i Aftësisë Profesionale për Përdoruesit e Makinerive të Rënda të Ndërtimit nga DPSHTRR. (DAP) për Eskavatoristët, Buldozeristët, Automakinistët.
- Leje Drejtimi kategoria C me Cerifikatë Aftësisë Profesionale për drejtuesit e mjeteve të destinuara për transportin e mallrave nga DPSHTRR. (CAP)
- të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë të paktën për **muajin e fundit (Maj 2026)**, nga data e hapjes së ofertave. **Shënim:** Kjo kërkesë nuk është e detyrueshme **për drejtuesit e mjeteve me qera**. Në këtë rast, disponimi i drejtuesve të mjeteve, mund të jetë nëpërmjet llojeve të ndryshme që parashikohen nga legjislacioni që rregullon fushën konkrete, **me kushtin që** subjekti të respektojë kërkesat e Autoritetit Kontraktor, në Njoftimin e Kontratës, në lidhje me “**Nënkontraktimin**” dhe “**Mbështetjen në kapacitetet e subjekteve të tjera**”.

**2.5.3** Operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duhet të kenë të punësuar një numër, të paktën, prej **60 (gjashtëdhjetë)** punonjësish, **përveç stafit drejtues menaxherial**, të cilët duhet të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë për **muajin e fundit (Maj 2026)** nga data e hapjes së ofertave vërtetuar me:

- a. Listëpagesat e punonjësve të konfirmuara nga autoritetet përkatëse sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën e deklaruar.

### **Argumentimi:**

*(Në zbatim të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, pika 4, si dhe VKM-së nr. 285 dt.12.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 39 “Kërkesa të vecanta për kontratat për punë publike”, pika 6 gërma c) dhe ç), Ligjit nr.8378 datë 22.07.1998 “Kodi rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, VKM-së nr.153 datë 07.04.2000 “Për miratimin e rregullores së zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar, si dhe në përputhje me zërat*

---



*e punimeve të parashikuara në preventivin e punimeve si dhe grafikun e detajuar të punimeve me kohët e punës, numrin e punonjësve, numrin e specialistëve, numrin e drejtuesve teknikë, licencat e nevojshme dhe makineritë dhe paisjet, të hartuar nga specialisti i fushës në njësinë e prokurimit).*

**Argumentimi për pikën 2.5.1:**

| STAFI DREJTUES TEKNIK<br>(në licencën e subjektit) | Argumentimi                                                      |
|----------------------------------------------------|------------------------------------------------------------------|
| Inxhinier ndërtimi                                 | Sipas kërkesës së licencës <b>NP4-A dhe NP6-B</b> për subjektin. |
| Inxhinier hidroteknik                              | Sipas kërkesës së licencës <b>NP7-A dhe NP8-A</b> për subjektin. |
| Inxhinier gjeodet                                  | Sipas kërkesës së licencës <b>N.S - 18: B</b> për subjektin.     |

**Argumentimi për pikën 2.5.2 gëma A:**

| SPECIALISTET E NDERTIMIT | Argumentimi                                                                                                                                                                                                                                                                                                     |
|--------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| Teknik ndërtimi          | Për ndjekjen e punimeve në përgjithësi.                                                                                                                                                                                                                                                                         |
| Topograf                 | Për punimet topografike gjatë zbatimit, kuotat dhe drejtimet në punimet e dy akseve rrugore, kurorën e digës, kanalin katastrofik, etj.                                                                                                                                                                         |
| Gurëpunues               | Sipas zërave në preventiv: Seksioni A.nr.12; An.2 nr.5; (Për pregatijen e gurit për plotësimin e kalldrëmit të digës dhe ndërtimin e gabionave me gur kave)                                                                                                                                                     |
| Hekurthyes               | Sipas zërave në preventiv: Seksioni An.1 nr.9; An.2 nr.6; An.3. nr.4; An.4 nr.4; B nr.6 dhe nr.7; An.6 nr.10; An.2 nr.6; 1 nr.4 dhe nr. 7; 2 nr.8 dhe 10; An7.                                                                                                                                                  |
| Saldator                 | Sipas zërave në preventiv: Seksioni An.6 nr.8, nr.9, nr.10 dhe nr.11; 1 nr.7; 2 nr.10 dhe 11; An.7 nr.7.                                                                                                                                                                                                        |
| Karpentjerë              | Sipas zërave në preventiv: Seksioni An.1 nr.4 dhe nr.5; An.2 nr.4; An.3 nr.3; An.4 nr.3; An.5 nr.3; An.2 nr.4; 1 nr.5; 2 nr.4 dhe nr.5; An.7 nr.3, nr.4, nr.5                                                                                                                                                   |
| Muratorë                 | Sipas zërave në preventiv: Seksioni A.nr.12; An.2 nr.5; (Për punimet për plotësimin e kalldrëmit të digës dhe ndërtimin e gabionave me gur kave dhe mureve të betonit)                                                                                                                                          |
| Punëtorë të tjerë        | Janë llogaritur 20 punëtorë që përfshihen në shumicën e proceseve të ndërtimit dhe kryesisht në gabionat me gurë e rrjetë, veshjen me beton të kanalit të shkarkimit katastrofik, mbjelljen e skarpatës me barë, mbushje e ngjeshje me dhe, të cilët janë dhe proceset që kanë numrin më të madh të punonjësve. |

**Argumentimi për pikën 2.5.2 gëma B:**

| DREJTUES TË MAKINERIVE TË RËNDA TË<br>NDËRTIMIT DHE DREJTUES KAMIONI                                                                         | Argumentimi                                                                                                                                                               |
|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <b>Eskavatorist</b> (i paisur me Dëshmi Aftësimi Profesional për Përdoruesit e Makinerive të Rënda të Ndërtimit nga DPSHTRR. ( <b>DAP</b> )) | Eskavator gjurmimi e ngarkimi dherash, të të gjitha llojeve si dhe fadromat e të gjitha llojeve (me goma dhe me zinxhirë), manovratorëve u jepet dëshmi për ESKAVATORIST; |

|                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                           |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                   |
|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
|                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                           | Për drejtimin e eskavatorëve, fadromave, minidameprave dhe minifadromave                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                          |
